



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2242/ 3 prot

Datë 28.09.2023

**V E N D I M**

**Nr. 966/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.09.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-79237-09-07-2023, me objekt “Blerje reagente pajisje laboratorit dhe impianti”, me fond limit 7,901,168.67 lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19-09-2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-79237-09-07-2023, me objekt “Blerje reagente pajisje laboratorit dhe impianti”, me fond limit 7,901,168.67 lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19-09-2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Krijon” SHPK NIPT K12023001A  
Adresa: Rr. Elbasanit, Nr.57, Çollak, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A.  
Adresa: L.17 Rr. Dalip Peza

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 24 e vijues, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I**

## Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

## Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08-09-2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-79237-09-07-2023, me objekt “Blerje reagente pajisje laboratorit dhe impianti” me fond limit 7,901,168.67 lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19-09-2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

II.2. Në datën 14.09.2023 operatori ekonomik ankimues “Krijon” SHPK, ka paraqitur ankesë ne forme shkresore pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 19.09.2023 nr 5017/4 prot., është depozituar shkresa me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Krijon” SHPK ”, protokolluar me tonën me nr. 2242/2 prot, datë 21.09.2023. Autoriteti kontraktor ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin mbi ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur që të pranojë pjesërisht pretendimet e ankimuesit, si më poshtë vijon:

*Referuar verifikimeve te bera nga GSHA rezulton se artikulli Test Nitrate N2/25, me diapazon I 0.5-18.0 mg/l NO3-N, 2.2-79.7 mg/l NO3 nuk eshte percaktuar sakte nga grupi i hartimit te specifikimeve, pasi rezulton se Testet e Nitrate N2/25 kane diapazon matje 0.5-25.0 mg/l NO3-N, 2.2-110.7 mg/l NO3. Gjithashtu dhe per testin Test Fosfori niveli ulet P6/26, diapazoni matjes eshte percaktuar gabim, pasi Test Fosfori niveli ulet duhet P6/25.*

28	Aparat per matjen e Klorit te lire	<p><i>Për matjen e klorit te lire.</i></p> <p><i>(Aparati duhet të jetë i pështatshem për reagentet e PF-3 ose ekuivalent pasi lidhen reagentet e kërkuar për artikullin nr. 36 te listes)</i></p> <p><i>Dedektori: Fotodiode silikoni ose ekuivalente</i></p> <p><i>Lloji i kyvetes 1'' e rrumbullaket 16mm ,rrumbullaket me adaptor</i></p> <p><i>(Sqarim: pasi lidhen me reagentet e kërkuar ne artikullin nr. 36 te listës)</i></p> <p><i>Vlerësimi i papërshkueshëm nga uji : IP 67 ose IP 68</i></p> <p><i>. Kushtet e funksionimit:</i></p>
----	------------------------------------	--

		<p><i>10 - 40 °C maksimumi.</i></p> <p><i>Lagështia relative max 90%</i></p> <p><i>Mënyra e funksionimit:</i></p> <p><i>Transmetimi (%), Absorbimi dhe Përqendrimi</i></p> <p><i>Sistemi optik: Transmetim 0 / 180 °</i></p> <p><i>Saktësia fotometrike:</i></p> <p><i>± 0,03 Abs Lineariteti fotometrik:</i></p> <p><i>± 0,002 Abs (0 - 1 Abs)</i></p> <p><i>Gama matjes fotometrike: 0-2 Abs      Riprodhueshmëria:</i></p> <p><i>± 0,005 Abs (0 - 1 A)</i></p> <p><i>Burimi i drites: Diodë që lëshon dritë (LED) Gjerësia e brezit spektral 15nm</i></p> <p><i>Drita e humbur: &lt; 1.0 % at 400 nm</i></p> <p><i>Temperature range: 0 - 50 °C</i></p> <p><i>Saktësia e gjatësisë së vales: ± 1 nm</i></p> <p><b><i>sqarim: pasi nqs hapet diapazoni vera del jashtë vlerës reale, pasi me përdorimin e pajisjes për një kohë të gjatë humbet saktësinë)</i></b></p> <p><i>Fushe e gjatësisë së vales: 420, 520, 560, 610 nm</i></p> <p><i>Zgjedhja e gjatësisë së vales: Ne menyre automatike</i></p> <p><b><i>sqarim: ne varesi të ndotjes së ujit provezale ujit ndryshon ngjyrë dhe për kete arsye zgjedhesi i gjatësisë së vales duhet të jetë automatik, pasi jo të gjithë mostrat e ujit janë të pastra)</i></b></p>
--	--	--

29	<p>Aparat për matjen e TDS &amp; pH për ujin e pijshëm</p>	<p>Aparature e certifikuar CE</p> <p>Eksport te te dhenave: me lidhje USB me kompjuter ose pajisje USB</p> <p><i>(Sqarim kerkohet te ketë opinionet e mesiperme per efekt të punës qe mos te hidhen te dhenat manualisht nga punonjesit e laboratorit)</i></p> <p>Ruajtja e te dhenave: min 9,000 te dhena</p> <p><i>(Sqarim: Kerkohet te ruaj sa me shume te dhena per efekt te punes qe ne rastet e fluksit te punes most e humbasin te dhenat )</i></p> <p>Dimensionet (L x Gj x Gj):63 mm x 97 mm x 220 mm( HIQET)</p> <p>Ekrani: Deri ne 3 parametra ne te njejten kohe ose me teper</p> <p>Lloji i ekranit: 536x336 Mono-TFT ( HIQET)</p> <p>Klasifikimi per depertushmerine e ujit: IP67 ose IP 68</p> <p>Lageshtira e ambientit: deri 90%</p> <p><i>(Sqarim: aparati eshte portabe dhe mund te perdoret edhe jashte ambienteve te laboratorit ne kushte lageshtire)</i></p> <p>Kushtet e pune: 0 - 60 °C</p> <p>Parameterat: pH, konduktivitetin</p> <p>Fusha e matjes e pH : 0 - 14 pH</p> <p><i>( Sqarim: ne lidhje me vlerat pH duhet te jene ne diapazonin e percaktuar nga Ak pasi jo gjithmon ejme matje te ujit te pijshem qe eshte i paster shpeshhere behen matje te ujrave te pijshem qe mund te kene ndotje te ndryshme)</i></p> <p>Resolucioni i pH qe zgjidhet: 0.001/0.01/0.1 pH</p> <p><i>(Sqarim: Pasi nqs hapet diapazoni vlera del jashte vleres reale)</i></p> <p>Fushe e matje e konduktivitetit:</p> <p>0.0 mg/L - 50.0 g/L NaCl</p> <p><i>Sqarim: ne lidhje me vlerat pH duhet te jene ne diapazonin e percaktuar nga Ak pasi jo gjithmonë me matje te ujit te pijshem</i></p>
----	--	--

		<p><i>qe eshte i paster shpeshhere behen matje te ujrave te pijshem qe mund te kene ndotje te ndryshme</i></p> <p><i>Me kompensim automatik te temperatures per pH</i></p> <p><i>(Sqarim: kushtet optimale te funksionimit te pajisjes jane ne temperaturen 20 grad C duke qene se stafi i laboratorit punon edhe ne terren kerkohet kompesimi automatik i temperatures per funksionimin sa me te mire te pajisjes)</i></p>
30	<p><i>Aparat per matjen e turbullshmerise per ujin e pijshem</i></p>	<p><i>Saktesia: <math>\pm 2</math> %e leximit dhe drites se humbur.</i></p> <p><i>(Sqarim: Pasi nqs hapet diapazoni vlera del jashte vleres reale, Psi me perdorimin e pajisjes per nje kohe te gjate humbet saktesine)</i></p> <p><i>Aparature e certifikuar CE</i></p> <p><i>Kuveta: 25 mm x 60 mm e rrumbullaket ( Hiqet)</i></p> <p><i>Ruan Minimumi 500 rekorde</i></p> <p><i>( Sqarim: Kerkohet te ruaj sa me shume te dhena per efekt te punes qe ne rastet e fluksit te punes te mos humbasin te dhenat)</i></p> <p><i>Dimensionet (L x Gj x Gj):77 mm x 107 mm x 229 mm( Hiqet)</i></p> <p><i>Madhesia e ekranit: 240 x 160 pixels( Hiqet)</i></p> <p><i>Lloji i ekranit: Graphic LCD ose ekuivalent</i></p> <p><i>Vlersimi I pershkrueshmerise nga uji:IP67 ose IP68</i></p> <p><i>Interface: Optional USB</i></p> <p><i>(Sqarim: kerkohet te kete opsionet e mesiperme per efekt te punes qe te most te hidhen te dhenat manualisht nga punonjesit</i></p>

	<p><i>e laboratorit)</i></p> <p><b><i>Burimi i drites: Llampe me filament Tungsteni ( Hiqet)</i></b></p> <p><i>Lageshtira maksimale e punes: 90 %</i></p> <p><i>Measuring range: 0 - 1000</i></p> <p><i>Njesia e matjes: NTU</i></p> <p><i>Temperatura e punimit: 0 - 50 °C</i></p> <p><i>Perseritshmeria: ± 1 % e leximit ose 0.01 NTU , cilado qofte me e larte</i></p> <p><i>Koha e reagimit: 6 s ne programimin normal te punes</i></p> <p><b><i>Vellimi i mostres: 10 ml</i></b></p>
--	---

*Ankesa e bere ne lidhje me kete pike nga OE ankimues merret pjeserisht ne konsiderate.*

II6. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk ka operatorë ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, konkretisht në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1.Referuar shkreses date 19.09.2023, nr. 5017/4 prot., objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së opeatorit ekonomik ‘Krijon’ SHPK ”, protokolluar me tonën me nr. 2242/2 rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin pjeserisht të ankesës, duke cituar se: “[...]Referuar verifikimeve

te bera nga GSHA rezulton se artikulli Test Nitrate N2/25, me diapazon I 0.5-18.0 mg/I NO3-N, 2.2-79.7 mg/I NO3 nuk eshte percaktuar sakte nga grupi i hartimit te specifikimeve, pasi rezulton se Testet e Nitrate N2/25 kane diapazon matje 0.5-25.0 mg/I NO3-N, 2.2-110.7 mg/I NO3. Gjithashtu dhe per testin Test Fosfori niveli ulet P6/26, diapazoni matjes eshte percaktuar gabim, pasi Test Fosfori niveli ulet duhet P6/25.

28	Aparat per matjen e Klorit te lire	<p>Për matjen e klorit te lire.</p> <p><b>(Aparati duhet të jetë i pështatshem për reagentet e PF-3 ose ekuivalent pasi lidhen reagentet e kërkuar per artikullin nr 36 te listes)</b></p> <p><b>Dedektori: Fotodiode silikoni ose ekuivalente</b></p> <p>Lloji i kyvetes 1'' e rrumbullaket 16mm ,rrumbullaket me adaptor</p> <p>(Sqarim: pasi lidhen me reagentet e kërkuar ne artikullin nr. 36 te listës)</p> <p><b>Vlerësimi i papërshkueshëm nga uji : IP 67 ose IP 68</b></p> <p>. Kushtet e funksionimit: 10 - 40 °C maksimumi.</p> <p>Lagështia relative max 90%</p> <p>Mënyra e funksionimit: Transmetimi (%), Absorbimi dhe Përqendrimi</p> <p>Sistemi optik: Transmetim 0 / 180 °</p> <p>Saktësia fotometrike: ± 0,03 Abs Lineariteti fotometrik: ± 0,002 Abs (0 - 1 Abs)</p> <p>Gama matjes fotometrike: 0-2 Abs Riprodhueshmëria: ± 0,005 Abs (0 - 1 A)</p> <p>Burimi i drites: Diodë që lëshon dritë (LED) Gjerësia e brezit spektral 15nm</p> <p>Drita e humbur: &lt; 1.0 % at 400 nm</p> <p>Temperature range: 0 - 50 °C</p> <p>Saktësia e gjatësisë se vales: ± 1 nm</p> <p><b>sqarim: pasi nqs hapet diapazoni vera del jashtë vlerës reale, pasi me përdorimin e pajisjes për një kohë të gjatë humbet</b></p>
----	------------------------------------	--



		<p><i>saktesine)</i></p> <p><i>Fushe e gjatesise se vales: 420, 520, 560, 610 nm</i></p> <p><i>Zgjedhja e gjatesise se vales: Ne menyre automatike</i></p> <p><b><i>sqarim: ne varesi të ndotjes së ujit provezale ujit ndryshon ngjyrë dhe për kete arsye zgjedhesi i gjatësisë së vales duhet të jetë automatik, pasi jo të gjithë mostrat e ujit janë të pastra)</i></b></p>
<b>29</b>	<i>Aparat për matjen e TDS &amp; pH për ujin e pijshëm</i>	<p><i>Aparature e certifikuar CE</i></p> <p><i>Eksport te te dhenave: me lidhje USB me kompiuter ose paisje USB</i></p> <p><b><i>(Sqarim kerkohet te ketë oprionet e mesiperme per efekt të punës qe most e hidhen te dhenat manualisht nga punonjesit e laboratorit )</i></b></p> <p><i>Ruajtja e te dhenave: min 9,000 te dhena</i></p> <p><b><i>(Sqarim: Kerkohet te ruaje sa me shume te dhena per efekt te punes qe ne rastet e fluksit te punes mos te humbasin te dhenat)</i></b></p> <p><b><i>Dimensionet (L x Gj x Gj):63 mm x 97 mm x 220 mm(HIQET)</i></b></p> <p><i>Ekrani: Deri ne 3 parametra ne te njejten kohe ose me teper</i></p> <p><b><i>Lloji i ekranit: 536x336 Mono-TFT ( HIQET)</i></b></p> <p><i>Klasifikimi per depertushmerine e ujit: IP67 ose IP 68</i></p> <p><i>Lageshtira e ambientit: deri 90%</i></p> <p><b><i>(Sqarim: aparati eshte portabe dhe mund te perdoret edhe jashte ambienteve te laboratorit ne kushte lagështire)</i></b></p> <p><i>Kushtet e pune: 0 - 60 °C</i></p> <p><i>Parameterat: pH, konduktivitetin</i></p> <p><i>Fusha e matjes e pH : 0 - 14 pH</i></p> <p><b><i>( Sqarim: ne lidhje me vlerat pH duhet te jene ne diapazonin e percaktuar nga Ak pasi jo gjithmonë me matje te ujit te pijshem qe eshte i paster shpeshhere behen matje te ujrave te pijshem qe mund te kene ndotje te ndryshme)</i></b></p>

		<p><i>Resolucioni i pH</i> qe zgjidhet: 0.001/0.01/0.1 pH</p> <p><i>(Sqarim: Pasi nqs hapet diapazoni vlera del jashte vleres reale)</i></p> <p><i>Fushe e matje e konduktivitetit:</i></p> <p>0.0 mg/L - 50.0 g/L NaCl</p> <p><i>Sqarim: ne lidhje me vlerat pH duhet te jene ne diapazonin e percaktuar nga Ak pasi jo gjithmonë me matje te ujit te pijshem qe eshte i paster shpeshhere behen matje te ujrave te pijshem qe mund te kene ndotje te ndryshme</i></p> <p><i>Me kompensim automatik te temperaturës per pH</i></p> <p><i>(Sqarim: kushtet optimale te funksionimit te pajisjes jane ne temperaturen 20 grad C duke qene se stafi i labororit punon edhe ne terren kerkohet kompesimi automatik i temperatures per funksionimin sa me temire te pajisjes)</i></p>
30	<p><i>Aparat per matjen e turbullshmerise per ujin e pijshem</i></p>	<p><i>Saktesia: ± 2 %e leximit dhe drites se humbur.</i></p> <p><i>(Sqarim: Pasi nqs hapet diapazoni vlera del jashte vleres reale, Psi me perdorimin e pajisjes per nje kohe te gjate humbet saktesine)</i></p> <p><i>Aparature e certifikuar CE</i></p> <p><i>Kuveta: 25 mm x 60 mm e rrumbullaket ( Hiqet)</i></p> <p><i>Ruan Minimumi 500 rekorde</i></p> <p><i>( Sqarim: Kerkohet te ruaj sa me shume te dhena per efekt te punes qe ne rastet e fluksit te punes te mos humbasin te dhenat)</i></p> <p><i>Dimensionet (L x Gj x Gj):77 mm x 107 mm x 229 mm( Hiqet)</i></p> <p><i>Madhesia e ekranit: 240 x 160 pixels( Hiqet)</i></p> <p><i>Lloji i ekranit: Graphic LCD ose ekuivalent</i></p> <p><i>Vlersimi I pershkrueshmerise nga uji:IP67 ose IP68</i></p> <p><i>Interface: Optional USB</i></p> <p><i>(Sqarim: kerkohet te kete opsionet e mesiperme per efekt te punes qe te mos te hidhen te dhenat manualisht nga punonjesit</i></p>

	<p><i>e laboratorit)</i></p> <p><b>Burimi i drites: Llampe me filament Tungsteni ( Hiqet)</b></p> <p><i>Lageshtira maksimale e punes: 90 %</i></p> <p><i>Measuring range: 0 - 1000</i></p> <p><i>Njesia e matjes: NTU</i></p> <p><i>Temperatura e punimit: 0 - 50 °C</i></p> <p><i>Perseritshmeria: ± 1 % e leximit ose 0.01 NTU , cilado qofte me e larte</i></p> <p><i>Koha e reagimit: 6 s ne programimin normal te punes</i></p> <p><i>Vellimi i mostres: <b>10 ml</b></i></p>
--	--

*Ankesa e bere ne lidhje me kete pike nga OE ankimues merret pjeserisht ne konsiderate.*

*Vendos: Te pranoje pjeserisht ankesen e paraqitur nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK per proceduren e prokurimit “Objekt reagente pajisje laboratorit dhe impjanti” .*

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjeserisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

**Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 2242 prot, datë 14.09.2023 të operatorit ekonomik “Krijon” SHPK.**

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK ku kërkon: “

[...]2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese autorizim nga prodhuesi /MAF/ ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku te provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nepermjet te cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet te tregtoje mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet te jete i vlefshem ne momentin e hapjes së ofertave dhe perfshire afatin e zbatimit te kontrates.

Se pari kerkesa per autorizim eshte nje kerkese e paargumentuar per kete objekt-prokurimi, pasi artikujt objekt tenderi jane materiale konsumi dhe aparate te vogla për te cilat nuk kane nevojë per instalim dhe mirëmbajtje dhe si rrjedhim nuk eshte ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates.

Se dyti, ne procesverbalin e argumentimit te kritereve te vendosura nga autoriteti kontraktor nuk eshte argumentuar ligjerisht dhe teknikisht kerkesa e paraqitjes se autorizimit ku thuhet "Autorizimi nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara eshte nje dokument i rendësishem i cili tregon aftësitë e operatorit ekonomik ofertues si dhe eshte një tregues cilësor i mallit qe do të ofrohet. Ne gjykim te autoritetit kontraktor, ky kriter eshte jo diskriminues, ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates dhe lidhet drejtperdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmerine e operatorit ekonomik ofertues per aftesite teknike gjykojmë se argumentimi i mësiperm i kerkesës për autorizim nuk gjen mbështetje ne LPP. Paraqitja e autorizimit jo vetëm që nuk është tregues i cilësise se mallit që do të ofrohet, por edhe nuk tregon ne menyre te drejtperdrejte aftesine teknike te operatorit ekonomik pjesmarres. Per te vertetuar cilësine dhe originalitetin e produkteve te ofruara ne tender eshte

*katalogu i cili ka te pasqyruar artikullin, kompanine prodhuese dhe detajimin e specifikimeve te ofertuara.*

*Se treti, pretendimi i autoritetit kontraktor, se "Kerkesa per autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i sherben autoritetit kontraktor per njohjen e mundësisë se operatorit ekonomik ofertues mbi permbushjen me sukses te kontrates" bie ndesh me kerkesat e LPP, i cili per te vertetuar aftësinë e permbushjes me sukses te kontrates ka kerkuar kriterë ekonomike si bilancet, vertetim xhiro, dhe kriter profesional paraqitjen e kontratave te ngjashme te realizuara 3 vitet e fundit. [...] Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, kapaciteti teknik, pika 2.3.2 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

**2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi /MAH/ ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë mallrat objekt - prokurimi.***

***Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave dhe përfshirë afatin e zbatimit të kontratës.***

III.2.2 Në kthimin e përgjigjes për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues me nr. 5017/4 prot., datë 19.09.2023, protokolluar me tonën nr. 2242/2 prot., datë 21.09.2023, për këtë pretendim autoriteti kontraktor në mënyrë të përmbledhur ka argumentuar: [...] *Ne procedurat e prokurimit për sherbime, ku eshte e nevojshme qe operatoret ekonomike te kene nje autorizim te veçante ose të jene anëtare te nje organizate të veçantë për te kryer sherbimin ne fjale ne shtetin e tyre te origjines, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkoje atyre te vertetojne se e kane kete autorizim ose anëtarësim". Autorizimi nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara eshte nje dokument i rendësishem i cili tregon aftësite e operatorit ekonomik ofertues si dhe eshtë nje tregues cilësor i mallit qe do te ofrohet. Ne gjykim te autoritetit kontraktor, ky kriter eshte jodiskriminues, ne perpjestim me natyrën dhe përmasat e kontrates de lidhet drejtpërdrejte me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmerine e operatorit ekonomik ofertues per aftësite teknike. AK gjykon se kriteri i percaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit te Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi eshte ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me objektin e kontratës si dhe ne perputhje me dispozitat ligjore te sipercituara. Autoriteti kontraktor, duke qene se eshte përfituesi direkt i kontrates objekt prokurimi. eshte ne te drejtën e tij te garantohet se operatoret ekonomike pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kerkoje ofertuesve te paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave te lëshuara direkt nga prodhuesi apo distributori. Pra nëpërmjet vendosjes se kriterit te sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do te furnizoje dhe do te permbushe kontratën me sukses."*

III.2.3. Në procesverbalin e argumentimeve autoriteti kontraktor është shprehur si me poshtë vijon në lidhje me kriterin e ankimuar, **Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të*

nenit 73 dhe nenit 77, pika 2 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku shprehimisht thuhet se: “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim”.

Autorizimi nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara është një dokument i rëndësishëm i cili tregon aftësitë e operatorit ekonomik ofertues si dhe është një tregues cilësor i mallit që do të ofrohet. Në gjykim të autoritetit kontraktor, ky kriter është jo diskriminues, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues për aftësitë teknike. Kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik ofertues mbi përmbushjen me sukses të kontratës.”

III.2.4. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.2.5 Neni 40, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

*“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.2.6 Në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit për të gjithë artikujt e kërkuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim

është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.2.7. Për sa më sipër, KPP nisur nga parashtrimet e operatorit ekonomik ankimes, gjykon se autoriteti kontraktor ka dështuar në argumentimin pse paraqitja e autorizimit të prodhuesit/distributorit të autorizuar është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe se kjo kërkesë nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Në të gjitha parashtrimet e paraqitura nga autoriteti kontraktor në lidhje me këtë pretendim, nuk ka justifikuar pse është pikërisht paraqitja e autorizimit të prodhuesit/distributorit të autorizuar, dokumenti i cili i jep garancinë e vetme për sigurimin e produktit të kërkuar në kohë dhe cilësi dhe se kjo nuk mund të realizohet nga dokumente të tjera të cilat autoriteti kontraktor ka kërkuar në kriteret kualifikuese apo në specifikimet teknike. Nga verifikimi i dokumenteve të tenderit të hartuara nga autoriteti kontraktor, KPP gjykon, se informacionin në lidhje me cilësinë e artikujve dhe mundësinë e sigurimit të tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, autoriteti kontraktor e siguron edhe përmes përmbushjes nga operatori ekonomik ankimes të kriterit për paraqitjen e **katalogut** ku përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kërkesa e autoritetit kontraktor që: *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë materialet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave*, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në kundërshtim me qëllimin e lex specialis si dhe rregullat e prokurimit publik, të cilat kanë si synim nxitjen e konkurrencës dhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e këtij kriteri për kualifikim nga dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Krijon" SHPK ku kërkon:

*2-Artikulli Nr. 42 "Pomp e dozimit dhe seti i injektimit të klorit", përcaktuar në shtojcën 5 është një pajisje industriale dhe si e tillë nuk ka asnjë lidhje me artikujt e tjere objekt prokurimi të cilët janë aparate dhe reagente. Vendosja e kësaj pajisjeje në tërësinë e artikujve objekt prokurimi pengon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike të specializuara në fushën e reagenteve dhe pajisjeve laboratorike. Kodi CPV i cituar në procedurën e prokurimit është Reagente Kimike 33696300-8, e cila nuk e përshin pajisjen e sipërcituar. Spas VKM nr. 457 datë 30.07.2021 "Miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit" Pomp dozimi ka kodin CPV 42122230-1. Bazuar në argumentimin e mësipërm, kërkojmë që kjo pajisje të prokurohet si LOT me vetë.*



III.3.2. Në shtojcën 4 “Formulari i specifikimeve teknike”, të dokumenteve të tenderit, autoriteti ka vendosur:

*Skicimet, parametrat teknik etj.*

*Specifikimi i Materialeve:*

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i artikullit</i>	<i>Specifikimet teknike</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Multiparameter portativ</i>	<i>Për matjen e pH, temperaturë, tensionit REDOX, përcueshmërisë, TDS, SAL dhe oksigjenit të tretur (matje optike).</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
<i>2</i>	<i>Perzieres magnetik</i>	<i>Me ngrohës me temperaturë maksimale 500°C, kapaciteti 10 litra (për llumin dhe ujë)</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
<i>3</i>	<i>Kabinet termostati</i>	<i>Për përzierje të vazhdueshëm për përcaktimin e BOD5</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
<i>4</i>	<i>Sistemi Induktiv Nxites</i>	<i>OxiTop IS 6</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
<i>5</i>	<i>Shishe dhe koka shishesh</i>	<i>OxiTop për BOD</i>	<i>Copë</i>	<i>6</i>
<i>6</i>	<i>Mini pompë laboratorike</i>	<i>Për sistemin e filtrimit të TSS</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
<i>7</i>	<i>Erlenmeyer vakumi 1000 ml</i>	<i>I montueshëm tek mini pompa laboratorike, me gotë 300 ml dhe kapëse</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
<i>8</i>	<i>Test Amoniaku niveli i ulët</i>	<i>0.010-2.000 mg/l NH4-N, 0.01 – 2.58 NH4</i>	<i>Kuti 25 kyveta</i>	<i>25</i>
<i>9</i>	<i>Test Amoniaku</i>	<i>4.0-80.0 mg/l NH4-N, 5.2 – 103.0 mg/l NH4</i>	<i>Kuti 25 kyveta</i>	<i>2</i>

	<i>niveli i lartë</i>			
10	<i>Test COD niveli i ulët C3/25</i>	<i>10-150 mg/l COD</i>	<i>Kuti 25 kyveta</i>	2
11	<i>Test COD niveli i lartë C4/25</i>	<i>25 -1500 mg/l COD</i>	<i>Kuti 25 kyveta</i>	25
12	<i>Test Nitrate N2/25</i>	<i>0.5-18.0 mg/l NO3-N, 2.2-79.7 mg/l NO3</i>	<i>Kuti 25 kyveta</i>	14
13	<i>Test Nitrite N5/25</i>	<i>0.010-0.700 mg/l NO2-N, 0.03-2.30 mg/l NO2</i>	<i>Kuti 25 kyveta</i>	17
14	<i>Test Azoti niveli i ulët</i>	<i>0.5-15.0 mg/l N</i>	<i>Kuti 25 kyveta</i>	2
15	<i>Test Azoti niveli i lartë</i>	<i>10-150 mg/l N</i>	<i>Kuti 25 kyveta</i>	2
16	<i>Test Fosfori niveli i ulët P6/26</i>	<i>0.05-5.00 mg/l, 0.2-15.3 PO4, 0.11- 11.46 mg/l P2O5</i>	<i>Kuti 25 kyveta</i>	26
17	<i>Test Fosfori niveli i lartë P7/25</i>	<i>0.5-25.0 mg/l P, 1.5-76.7 mg/l PO4, 1.1-57.3 mg/l P2O5</i>	<i>Kuti 25 kyveta</i>	2
18	<i>Test Ortofosfate niveli i lartë P7/25</i>	<i>0.5-25.0 mg/l PO4-P, 1.5-76.7 mg/l PO4, 1.1-57.3 P2O5</i>	<i>Kuti 25 kyveta</i>	2
19	<i>Frenues i nitrifikimit</i>	<i>shishe 50 ml</i>	<i>Shishe</i>	15
20	<i>Bateri për kokat e shisheve të BOD</i>	<i>CR 2450, 3V LITHIUM</i>	<i>Copë</i>	12
21	<i>Kuveta kuarci, 10</i>	<i>Kuveta standarte të spektrofotometrit, volumi 3.5 ml Permasat: 12.5 mm x</i>	<i>Copë</i>	6

	<i>mm</i>	<i>12.5 mm x 45mm</i>		
22	<i>Doreza 1 perdorimshe</i>	<i>Sterile pa puder, kuti me 100 copë, masa 2xl</i>	<i>Kuti</i>	<i>20</i>
23	<i>Alkol etilik 96 %</i>	<i>I denatruar, dezinfektant për përdorim të jashtëm, bidon 1 litër</i>	<i>Bidon</i>	<i>20</i>
24	<i>Peleta hidroksid natriumi</i>	<i>Për përcaktimin e BOD me Ox top, kuti 1 kg</i>	<i>Kuti</i>	<i>1</i>
25	<i>Filtra (mikrofibra qelqi) për TSS</i>	<i>Ø 47 mm mikrofibra qelqi tip MGC, kuti 100 copë</i>	<i>Kuti</i>	<i>6</i>
26	<i>Filtra (mikrofibra qelqi) për TSS</i>	<i>Ø 90 mm mikrofibra qelqi, kuti 200 copë</i>	<i>Kuti</i>	<i>1</i>
27	<i>Pajisje për matjen e llumit</i>	<i>Plastike, e tejdukshme, e ndarë në 3 pjesë, H= 4.5 metra, d= 32 mm</i>	<i>Cope</i>	<i>2</i>
28	<i>Aparat per matjen e Klorit te lire</i>	<p><i>Për matjen e klorit te lire.</i></p> <p><b><i>(Aparati duhet të jetë i pështatshem për reagentet e PF-3 ose ekuivalent)</i></b></p> <p><i>Dedektori: Fotodiode silikoni.</i></p> <p><i>Lloji i kyvetes 1'' e rrumbullaket 16mm ,rrumbullaket me adaptor</i></p> <p><i>Vlerësimi i papërshkueshëm nga uji :</i></p> <p><i>IP 67. Kushtet e funksionimit: 10 - 40 °C maksimumi.</i></p> <p><i>Lagështia relative max 90%</i></p> <p><i>Mënyra e funksionimit:</i></p> <p><i>Transmetimi (%), Absorbimi dhe Përqendrimi</i></p>	<i>Cope</i>	<i>1</i>

		<p><i>Sistemi optik: Transmetim 0 / 180 °</i></p> <p><i>Saktësia fotometrike:</i>  <math>\pm 0,03</math> Abs <i>Lineariteti fotometrik:</i>  <math>\pm 0,002</math> Abs (0 - 1 Abs)</p> <p><i>Gama matjes fotometrike: 0-2 Abs</i></p> <p><i>Riprodhueshmëria:</i>  <math>\pm 0,005</math> Abs (0 - 1 A)</p> <p><i>Burimi i dritës: Diodë që lëshon dritë (LED) Gjerësia e brezit spektral 15nm</i></p> <p><i>Drita e humbur: &lt; 1.0 % at 400 nm</i></p> <p><i>Temperature range: 0 - 50 °C</i></p> <p><i>Saktësia e gjatësisë së vales: <math>\pm 1</math> nm</i></p> <p><i>Fushe e gjatësisë së vales: 420, 520, 560, 610 nm</i></p> <p><i>Zgjedhja e gjatësisë së vales: Ne menyre automatike</i></p>		
<b>29</b>	<i>Aparat për matjen e TDS &amp; pH për ujin e pijshëm</i>	<p><i>Aparature e certifikuar CE</i></p> <p><i>Eksport te te dhenave: me lidhje USB me kompiuter ose paisje USB</i></p> <p><i>Ruajtja e te dhenave: 10,000 te dhena</i></p> <p><i>Dimensionet (L x Gj x Gj): 63 mm x 97 mm x 220 mm</i></p> <p><i>Ekrani: Deri ne 3 parametra ne te njejten kohe</i></p> <p><i>Lloji i ekranit: 536x336 Mono-TFT</i></p> <p><i>Klasifikimi per depertushmerine e ujit: IP67</i></p> <p><i>Lageshtira e ambientit: 90%</i></p> <p><i>Kushtet e pune: 0 - 60 °C</i></p>		<i>1</i>

		<p><i>Parameterat: pH, konduktivitetin</i></p> <p><i>Fusha e matjes e pH : 0 - 14 pH</i></p> <p><i>Resolucioni i pH qe zgjidhet:</i> <i>0.001/0.01/0.1 pH</i></p> <p><i>Fushe e matje e konduktivitetit:</i></p> <p><i>0.00 mg/L - 50.0 g/L NaCl</i></p> <p><i>Me kompensim automatik te</i> <i>temperatures per pH</i></p>		
<b>30</b>	<p><i>Aparat per</i> <i>matjen e</i></p> <p><i>turbullshmer</i> <i>ise per ujin e</i></p> <p><i>pijshem</i></p>	<p><i>Saktesia: ± 2 %e leximit dhe drites se</i> <i>humbur. Aparature e certifikuar CE</i></p> <p><i>Kuveta: 25 mm x 60 mm e rrumbullaket</i></p> <p><i>Ruan 500 rekorde</i></p> <p><i>Dimensionet (L x Gj x Gj):77 mm x 107</i> <i>mm x 229 mm</i></p> <p><i>Madhesia e ekranit: 240 x 160 pixels</i></p> <p><i>Lloji i ekranit: Graphic LCD</i></p> <p><i>Vlersimi I pershkrueshmerise nga</i> <i>uji:IP67</i></p> <p><i>Interface: Optional USB</i></p> <p><i>Burimi i drites: Llampe me filament</i> <i>Tungsteni</i></p> <p><i>Lageshtira maksimale e punes: 90 %</i></p> <p><i>Measuring range: 0 - 1000</i></p>		<i>1</i>

		<p><i>Njesia e matjes: NTU</i></p> <p><i>Temperatura e punimit: 0 - 50 °C</i></p> <p><i>Perseritshmeria: ± 1 % e leximit ose 0.01 NTU , cilado qofte me e larte</i></p> <p><i>Koha e reagimit: 6 s ne programimin normal te punes</i></p> <p><i>Vellimi i mostres: 15 ml</i></p>		
31	<i>Teste per Koliforme Totale</i>	<i>Metoda e filtrimit ne membrane nutri-disk 0.45um 14053-47-N ose ekuivalent</i>	<i>Copë</i>	<i>1000</i>
32	<i>Test Nitrate</i>	<i>0.20 - 20.0 mg/l NO3-N, 0.9 – 88.5 mg/l NO3-</i>	<i>Kuti 250 teste</i>	<i>6</i>
33	<i>Test Nitrite</i>	<i>0.002 - 1.00 mg/l NO2-N, 0.007 – 3.28 mg/l NO2-</i>	<i>Kuti 250 teste</i>	<i>4</i>
34	<i>Test Amoniaku</i>	<i>0.010 - 3.00 mg/l NH4-N</i>	<i>Kuti 250 teste</i>	<i>6</i>
35	<i>Filtra Mikrobiolog jik 47 mm per e-coli</i>	<i>Enterococcu, total coliform 0.45um, sterile me kuadrate</i>	<i>Copë</i>	<i>3000</i>
36	<i>Test Klor i lire , test per Fotometer</i>	<i>Reagent pluhur per percaktimin e Klorit te lire ne ujin e pijshem PF-3 ose ekuivalent</i>	<i>Teste</i>	<i>5000</i>
37	<i>Teste per e-Coli</i>	<i>Metoda e filtrimit ne membrane nutridisk 0.45um 14068-47-N ose ekuivalent</i>	<i>Copë</i>	<i>1000</i>
38	<i>Teste per</i>	<i>Metoda e filtrimit ne membrane</i>	<i>Copë</i>	<i>1000</i>

	<i>Enterococcus faecal</i>	<i>nutridisk 0.45um 14051-47-N ose ekuivalent</i>		
39	<i>Kontenitore sterile plastike</i>	<i>1 përdorimësh, 500ml për mostra baktoreologjike</i>	<i>Copë</i>	<i>1000</i>
40	<i>Bateri per paisjen PF3</i>	<i>1,5 V</i>	<i>Copë</i>	<i>60</i>
41	<i>Kontenitore sterile plastike</i>	<i>1 përdorimësh, 100ml për mostra baktoreologjike</i>	<i>Copë</i>	<i>200</i>
42	<i>Pomp e dozimit dhe seti i injektimit te klorit</i>	<p><i>Presioni maksima i moskthimit 4 bar</i></p> <p><i>Vellimi maksimal i injektimit 49 l/ore</i></p> <p><i>Numri maksimal impulseve 200/min</i></p> <p><i>Vellimi i nje impulsi 4.08 ml</i></p> <p><i>Ekran me ndricim 3" ; pamje 3-LED per funksionimin,mesazhe paralajmeruese si dhe gabimet dhe qe shihet nga te tre anet</i></p> <p><i>Ne programimin manual pulsimit mund te vendosen nga 1 impuls/h deri ne 12.000 impulse/h</i></p> <p><i>Gjatesia e impulsit mund te vendoset elektronikisht nga 0-100%</i></p> <p><i>Impulset mund te gradohen ne menyra te ndyshme duke rritur dhe zvogeluar kohen e tyre si dhe ne menyre rritese dhe zvogelues.</i></p> <p><i>Faktori per kontrrollin e kontaktit nga jashte 99:1-1:99 ; Gradim ne AUT ne shkalle me te vogel se 1 ml</i></p> <p><i>Mundesit lidhje me 2 celesa niveli</i></p>	<i>Cope</i>	<i>1</i>

		3 porta shtese per hyrje/dalje dixhitale		
--	--	--	--	--

***Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:***

*Operatori Ekonomik gjithashtu duhet :*

1. *Të kryeje kontrollin e cilësisë së analizave me solucione etalone të rekomanduara sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor*
2. *Të kryeje testimet dhe kalibrimet e paisjeve objekt të prokurimit sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor*

III.3.3. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet shkresës nr.5017/4 prot., datë19.09.2023, protokolluar me tonën me nr. 2242/2 prot., datë 21.09.2023, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës se operatorit ekonomik ‘Krijon’ SHPK ”, në lidhje me këtë kërkesë shprehet, se ”Artikulli pompe dozimi dhe seti i injektimit te klorit verehet se eshte nje artikull i njejte me paisjet e tjera te laboratorit sic eshte pompa e vakumit apo aparati për matjen e klorit te lire qe ka lidhje te ngushte per monitorimin dhe dozimin e klorit me ujin e pijshem. Dozimi dhe menyra e injektimit te klorit ne ujin e pijshem lidhet direkt dhe me monitorimin e te gjitha parametrave që laboratoret tona kryejne gjate marrjes se mostrave dhe ekzaminimit te analizave. Nga sa me sipër artikulli ne fjale i sherben qellimit dhe ka lidhje te ngushte me marrjen e analizave dhe ndarja ne lote mund te vonoi dorëzimin e mallrave objekt procedure duke qene se do te funksionojnë si procedura me vete, gje që mund te shkaktoi probleme ne proceset e punes. Per sa i perket kodit CPV Autoriteti Kontraktor ka perzgjedhur kodin e reagenteve kimik, pasi zene pjesën me te madhe te mallrave objekt - prokurimi. Objekti i prokurimit perfshin reagente dhe pajisje laborator si aparate, pompa apo sete që kanë lidhje me reagentet.[...]

III.3.4 Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- a) *të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) *të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) *të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) *të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) *të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.3.5. Neni 39 i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:



1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve. **Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.**

2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet. Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen.

3. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

III.3.6. Neni 42 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet shprehimisht se:

1. *Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*
2. *Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale*

III.3.7 Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.3.7. Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, për ndarjen e kësaj procedure në lote, specifikisht për artikullin nr.42 (*Pomp e dozimit dhe seti i injektimit të klorit*) e rrjedhimisht kjo con në anulimin e saj, Komisioni i Prokurimit Publik thekson se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit (hartimit të kriterëve kualifikuese nga njësia e prokurimit), pasi ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin, nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në njëfarë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

Referuar vendimit të autoritetit kontraktor, protokolluar pranë institucionit tonë në datë 21.09.2023, ku ky i fundit argumenton se “[...]Artikulli pompe dozimi dhe seti i injektimit të klorit verëhet se është një artikull i njëjtit me paisjet e tjera të laboratorit sic është pompa e vakumit apo aparati për matjen e klorit të lirë që ka lidhje të ngushtë për monitorimin dhe dozimin e klorit me ujë të pijshëm. Dozimi dhe menyra e injektimit të klorit në ujë të pijshëm lidhet direkt dhe me monitorimin e të gjitha parametrave që laboratorët tona kryejnë gjatë marrjes së mostrave dhe ekzaminimit të analizave. Nga sa më sipër artikulli në fjalë i shërben qëllimit dhe ka lidhje të ngushtë me marrjen e analizave dhe ndarja në lote mund të vonojë dorëzimin e mallrave objekt procedure duke qenë se do të funksionojnë si procedura me vetë, gjë që mund të shkaktojë probleme në proceset e punës. Për sa i përket kodit CPV Autoriteti Kontraktor ka përzgjedhur kodin e reagenteve kimik pasi zënë pjesën më të madhe të mallrave objekt prokurimi. Objekti i prokurimit përfshin reagente dhe pajisje laboratorit si aparate, pompa apo sete që kanë lidhje me reagentet.. [...]”

Sa më sipër, pas shqyrtimit të pretendimeve të ankimuesit, dokumenteve të tenderit, si dhe kthim - përgjigjes në lidhje me këtë pikë të autoritetit kontraktor, KPP nuk e gjykon të drejtë pretendimin e ankimuesit lidhur me ndarjen me lote të procedurës së prokurimit, pasi ndarja në Lote e kësaj procedure, do të komplikonte procedurën, edhe realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.4 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK ku kërkon:

28	Aparat per	Për matjen e klorit të lirë.
----	------------	------------------------------

<p>matjen e Klorit te lire</p>		<p><b>(Aparati duhet të jetë i pështatshem për reagentet e PF-3 ose ekuivalent)</b></p> <p>Dedektori: Fotodiode silikon.</p> <p>Lloji i kyvetes 1'' e rrumbullaket 16mm ,rrumbullaket me adaptor</p> <p>Vlerësimi i papërshkueshëm nga uji : IP 67. Kushtet e funksionimit:</p> <p>10 - 40 °C maksimumi.</p> <p>Lagështia relative max 90%</p> <p>Mënyra e funksionimit:</p> <p>Transmetimi (%), Absorbimi dhe Përqendrimi</p> <p>Sistemi optik: Transmetim 0 / 180 °</p> <p>Saktësia fotometrike:</p> <p>± 0,03 Abs Lineariteti fotometrik:</p> <p>± 0,002 Abs (0 - 1 Abs)</p> <p>Gama matjes fotometrike: 0-2 Abs Riprodhueshmëria:</p> <p>± 0,005 Abs (0 - 1 A)</p> <p>Burimi i drites: Diodë që lëshon dritë (LED) Gjerësia e brezit spektral 15nm</p> <p>Drita e humbur:&lt; 1.0 % at 400 nm</p> <p>Temperature range: 0 - 50 °C</p> <p>Saktësia e gjatesise se vales: ± 1 nm</p> <p>Fushe e gjatesise se vales: 420, 520, 560, 610 nm</p> <p>Zgjedhja e gjatesise se vales: Ne menyre automatike</p>
--------------------------------	--	--

Specifikimet teknike te vendosura jane te aparatit DR900 e cila prodhohet nga Kompania HACH, e cila ka si distributor zyrtar ALBUJI sh. p.k. Bashkengjitur do te gjeni katalogun zyrtar te HACH ku shihet qarte perputhja me keto specifikime. Hartimi i ketyre specifikimeve eshte haptazi ne kundërshtim me nenin 36 te ligjit nr. 162/2020 LPP-se "4.Ne specifikimet teknike, nese nuk e justifikon objekti i kontratën nuk duhet te permendet asnje marke prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose sherbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnje marke tregtare, patente, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qellim favorizimin ose eliminimin e disa sipermarrjeve ose produkteve". Autoriteti Kontraktor duhet te vërtetoje qe specifikimet teknike duhet t'i plotësojne te pakten dy prodhues dhe duhet t'i deklaroje

emrat e tyre ne menyre qe te hedhe poshte pretendimet tona. Kerkojme nga Autoriteti Kontraktor te na ofroje prodhuesin e dyte te tyre.

Per artikullin 29.

<p><b>29</b></p>	<p>Aparat për matjen e TDS &amp; pH për ujin e pijshëm</p>	<p>Aparature e certifikuar CE  Eksport te te dhenave: me lidhje USB me kompiuter ose paisje USB  Ruajtja e te dhenave:10,000 te dhena  Dimensionet (L x Gj x Gj):63 mm x 97 mm x 220 mm  Ekрани: Deri ne 3 parametra ne te njejten kohe  Lloji i ekranit: 536x336 Mono-TFT  Klasifikimi per depertushmerine e ujit: IP67  Lageshtira e ambientit: 90%  Kushtet e pune: 0 - 60 °C  Parameterat: pH, konduktivitetin  Fusha e matjes e pH : 0 - 14 pH  Resolucioni i pH qe zgjidhet: 0.001/0.01/0.1 pH  Fushe e matje e konduktivitetit:  0.00 mg/L - 50.0 g/L NaCl  Me kompensim automatik te temperatures per pH</p>
------------------	--	--

Specifikimet teknike te permendura jane ato për aparatin HQ2100 e cila prodhohet nga kompania HACH e cila ka si distributor zyrtar ne Shqiperi ALBUJI sh.p.k. Specifikimet e kerkuara jane shume te detajuara me elemente te panevojshme ne lidhje me funksionin e ketij aparati. Autoriteti Kontraktor duhet te hartoje specifikime teknike gjithperfshirese duke krijuar kushte per konkurrim te paanshem e te hapur ndërmjet te gjithe kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa me sakte dhe ne menyre te plote karakteristikat e mallrave/sherbimeve/punëve dhe ne perputhshmeri me objektin e kontratës. Kerkesa e Autoritetit Kontraktor per te dorezuar autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar, i cili ne kete rast eshte HACH si kompani prodhuese dhe ALBUJI sh.p.k. si distributor dhe percaktimi i specifikimeve teknike te cilat çojnë drejt nje prodhuesi dhe nje distributori shkel pikerisht parimin e barazise dhe konkurrences se drejte mes operatoreve ekonomike. Kerkojme nga Autoriteti Kontraktor te na informoje cilet jane prodhuesit e tjere qe plotesojne specifikimet e kerkuara. Kerkojme te ndryshohen specifikimet ne menyre qe te plotesohen te pakten nga 2-3 prodhues te tjere qe te lejohet pjesmarrja e te gjithe operatorëve të interesuar.

Artikulli nr 30

30	Aparat për matjen e turbullshmërisë për ujë në pijshëm	<p>Saktësia: <math>\pm 2\%</math> e leximit dhe dritës së humbur. Aparature e certifikuar CE</p> <p>Kuveta: 25 mm x 60 mm e rrumbullakët</p> <p>Ruan 500 rekorde</p> <p>Dimensionet (L x Gj x Gj): 77 mm x 107 mm x 229 mm</p> <p>Madhësia e ekranit: 240 x 160 pixels</p> <p>Lloji i ekranit: Graphic LCD</p> <p>Vlersimi I përshkrueshmerisë nga uji: IP67</p> <p>Interface: Optional USB</p> <p>Burimi i dritës: Llampe me filament Tungsteni</p> <p>Lageshtira maksimale e punës: 90 %</p> <p>Measuring range: 0 - 1000</p> <p>Njësia e matjes: NTU</p> <p>Temperatura e punimit: 0 - 50 °C</p> <p>Perseritshmeria: <math>\pm 1\%</math> e leximit ose 0.01 NTU , cilado qofte me e larte</p> <p>Koha e reagimit: 6 s në programimin normal të punës</p> <p>Vëllimi i mostres: 15 ml</p>
----	--	--

Specifikimet teknike të cituara janë ato të aparatit 2100Q i cili prodhohet nga kompania HACH e cila ka si distributor në Shqipëri ALBUJI sh.p.k. Në respekt të parimit të trajtimit të barabartë, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/perjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues ose prodhues. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qofte ato të dukshme, qofte ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Kërkojmë të ndryshohen specifikimet në mënyrë që të plotësohen të pakten nga 2-3 prodhues të tjere që të lejohet pjesëmarrja e të gjithë operatorëve të interesuar në këtë procedurë tenderimi.

Artikulli nr. 42

42	Pompë e dozimit dhe seti i injektimit të klorit	<p>Presioni maksimal i moskthimit 4 bar</p> <p>Vëllimi maksimal i injektimit 49 l/ore</p> <p>Numri maksimal i impulseve 200/min</p> <p>Vëllimi i një impulsi 4.08 ml</p> <p>Ekran me ndricim 3" ; pamje 3-LED për funksionimin, mesazhe paralajmëruese si dhe gabimet dhe që shihet nga të tre anët</p>	Cope	1
----	---	---	------	---

		<p><i>Ne programimin manual pulsimet mund te vendosen nga 1 impuls/h deri ne 12.000 impulse/h</i></p> <p><i>Gjatesia e impulsit mund te vendoset elektronikisht nga 0-100%</i></p> <p><i>Impulset mund te gradohen ne menyra te ndyshme duke rritur dhe zvogeluar kohen e tyre si dhe ne menyre rritese dhe zvogelues.</i></p> <p><i>Faktori per kontrollin e kontaktit nga jashte 99:1-1:99 ; Gradim ne AUT ne shkalle me te vogel se 1 ml</i></p> <p><i>Mundesit lidhje me 2 celesa niveli</i></p> <p><i>3 porta shtese per hyrje/dalje digjitale</i></p>		
--	--	---	--	--

*Specifikimet teknike për këto pompe janë të pompës dozimi GXLa 0450 që prodhohet nga kompania ProMinent e cila ka gjithashtu distributor në Shqipëri ALBUJI sh.p.k. Bashkëngjitur do të gjeni katalogun zyrtar të ProMinent si dokument provues. Kërkesa e Autoritetit Kontraktor për të dorëzuar autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar, i cili në këto rast është ProMinent si kompani prodhuese dhe ALBUJI si distributor dhe percaktimi i specifikimeve teknike të cilat çojnë drejt një prodhuesi dhe një distributori shkel përkrahje parimore e barazisë dhe konkurrencës së drejtë mes operatoreve ekonomike. Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktor të na informojë cilat janë prodhuesit e tjerë që plotësojnë specifikimet e kërkuara. Kërkojmë të ndryshohen specifikimet në mënyrë që të plotësohen të pakten nga 2-3 prodhues të tjerë në mënyrë që të lejohet pjesëmarrja e të gjithë operatoreve të interesuar. Komisioni i Prokurimit Publik në shumë vendime të tij ka cituar që është shumë e rëndësishme që përmes specifikimeve teknike autoriteti kontraktor të mundësojë konkurrencë të drejtë, të hapur, gjithëpërfshirë të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomike si dhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh.*

*Sa më sipër, konstatojmë se specifikimet teknike të parashikuara në shprehjen 5 “Folrumari i Specifikimeve teknike bien në kundërshtim të hapur me ligjin nr 162/2020 dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”*

III.4.1. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale, duke verifikuar

(krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “*elementet e domosdoshme të ankesës*” sipas përcaktimeve të nenit 48, “*Kushtet formale të ankesës*”, pika 3:

- Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, se kërkesat e autoritetit kontraktor nuk janë të bazuara në ligj, ankimuesi duhet të jetë më i qartë në kërkesat për modifikim, të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga autoriteti kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e autoritetit kontraktor dhe të hartojë e argumentojë të gjitha kërkesat e procedurës së prokurimit në themel. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për këto specifikime në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, pesha specifike e barrës për të provuar shkeljen e konstatuar qëndron mbi pretenduesin, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plota provuese, se cilat kritere/specifikime teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë të paqarta dhe konfuze.

Një pretendim pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një quasi gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik, i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Krijon” SHPK “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-79237-09-07-2023, me objekt “Blerje reagente pajisje laboratorit dhe impianti” me fond limit 7,901,168.67 lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19-09-2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sh.A.
  2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimues “Krijon” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**